



***Doracak për liçencim të
zyrave dhe institucioneve
për arsimimin e të rriturve***



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

Dhjetor 2011

Përmbajtja

1. Qëllimi i doracakut	3
2. Ligjet dhe aktet nënligjore	3
3. Kushtet e nevojshme për liçencim të ofruesëve të shërbimeve për arsimimin e të rriturve	4
3.1. Sigurimi i kualitetit nga ana e zyrave dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve.....	4
3.2. Ofruesi i shërbimeve udhëheq/siguron sistem të dokumentuar të cilësisë sipas kritereve të Inspektoratit shtetëror të arsimit dhe e përdor për të aritur qëllimet e veta programore.....	4
3.3. Ofruesi i shërbimeve i siguron dhe i përmirëson kuadrot me qëllim të arritjes së qëllimeve të veta programore	5
3.4. Ofruesi i shërbimeve ka kushte hapësinore, mjete mësimore dhe mjete ndihmëse arsimore për realizimin e aktiviteteve adekuate programore	5
3.5. Informim i rregullt i Ministrisë për arsim dhe shkencë nga ana e entit/insitucionit për arsimimin e të rriturve	6
4. Dorëzimi i kërkesës për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsim të të moshuarëve të cilët ofrojnë programe të posaçme për arsimin e të rriturve të cilët shkojnë drejt kualifikimeve profesionale.....	6
4.1. Shqyrtim i dokumentacionit të institucioneve dhe enteve për arsimimin e të rriturve	9
4.2. Veprimet për miratim të vendimit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve.....	9
4.3. Mbikëqyrja inspektorale nga ana e Inspektoratit shtetëror për arsim	10
4.4. Tërheqje e vendimit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve	11
5. Plotësim i kërkesës për liçencim dhe përgatitje e elaboratit	11
5.1. Kërkesa për liçencim	11
5.2. Elaborati.....	12
6. Shtojcë	
6.1. Shtojca 1: Definicionet e kuptimeve	13



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

1. Qëllimi i doracakut

Qëllimi i doracakut për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve (ofrues të shërbimeve) është t'ju ndihmojë, t'i orientojë dhe t'i përkrah entet dhe insitucionet në procesin e liçencimit për arsimimin e të rriturve. Doracaku, kërkesa për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, si edhe dokumentet e tjera për liçencim mund t'i gjeni në faqen e internetit të Ministrisë për arsim dhe

shkencë të R. së Maqedonisë www.mon.gov.mk dhe në faqen e internetit të IP për arsimimin e të rriturve www.cov.gov.mk. Të gjitha pyetjet shitesë për liçencim të enteve/insitucioneve për arsimimin e të rriturve mund të drejtohen deri te sektori për arsim fillor dhe të mesëm pranë Ministrisë për arsim dhe shkencë.

2. Ligjet dhe aktet nënligjore

Liçencimi i enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve bëhet konform:

- Ligjit për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr.7/08, 17/11, 51/11);
- Rregullorja për përmbajtjen, formën dhe evidencën e dokumentacionit që udhëhiqet nga entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve;
- Rregullorja për emrin, përmbajtjen dhe formën e çertifikatës për njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe kompetencat e fituara nga programet e veçanta për arsimimin e të rriturve;
- Rregullorja për mënyrën dhe formën e udhëheqjes së regjistrimit qendror dhe atij komunal për institucionet dhe entet të cilat realizojnë programe për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R së Maqedonisë nr. 37/10);
- Rregullorja për mënyrën e verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve (akt i brendshëm i miratuar nga këshilli drejtues);

- Rregullorja për përmbajtjen, formën dhe veprimet e nënshkrimit të ndjekjes se programit për arsimimin e të rriturve (të miratuar nga drejtori i Qendrës për arsimimin e të rriturve);
- Rregullorja për standardet, hapësirën dhe pajisjet e institucioneve dhe enteve për arsimimin e të rriturve (miratuar nga ministria për arsim dhe shkencë), si edhe dispozitat e Ligjit për arsim fillor, Ligjit për arsim të mesëm, Ligjit për trajnim dhe arsim profesional, Ligjit për arsim sipëror dhe dispozitat nga aktet nënligjore që i rregullojnë standardet për hapësirë dhe pajisje për arsimin fillor, të mesëm dhe arsimin sipëror dhe Normativat për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse për drejtimet në arsimin e mesëm përkatës, katërvjeçar.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

3. Kushtet e nevojshme për liçencim të ofruesëve të shërbimeve për arsimimin e të rriturve

3.1. Sigurim i kualitetit nga ana e enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve

- Ofruesit e shërbimeve për arsim të të rriturve kanë qëllime zhvillimore të definuara në pajtueshmëri me prioritetet nacionale për arsim dhe për arsim të të rriturve.
- Ofruesi i shërbimeve për arsimimin e të rriturve komunikon me institucionet përkatëse, vetëqeverisjen lokale dhe me pjesëmarësit në programet, me qëllim të ofrimit të shërbimit sa më cilësor dhe realizimit sa më efikas të qëllimeve të parapara.
- Ofruesi i shërbimeve për arsimimin e të rriturve, ka vendosur mekanizëm për evaluimin e qëllimeve të aritura nga aktivitetet programore dhe në bazë të njohurive të fituara nga evaluimi e planifikon zhvillimin e aktiviteteve tjera programore.
- Ofruesi i shërbimeve për arsimimin e të rriturve rregullisht ndjek realizimin e aktiviteteve programore dhe e përmirëson cilësinë e aktiviteteve programore.

3.2. Ofruesi i shërbimeve mban/siguron sistem të dokumentuar të cilësisë sipas kriterëve të Inspektoratit shtetëror për arsim dhe e përdor të njëjtin për t'i arritur qëllimet e veta programore

- Ofruesi i shërbimeve ka strukturë të definuar të drejtimit, përgjegjësi dhe funksione të ndara.
- Ofruesi i shërbimeve ka strukturë organizative, përgjegjësi të ndara në pjesën e menaxhimit, punës financiare, kuadrit arsimor, personelit administrativ dhe atij ndihmës.
- Ofruesi i shërbimeve në mënyrë sistematike, implementon sistem të dokumentuar të cilësisë sipas kriterëve të Inspektoratit shtetëror të arsimit dhe vazhdimisht e përmirëson procesin arsimor.
- Ofruesi i shërbimeve punon sipas rregullave të përshkruara ligjore në sferën e punës financiare.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

3.3. Ofruesi i shërbimeve e siguron dhe e përmirëson kuadrin me qëllim të aritjes së qëllimeve të caktuara programore

- Ofruesi i shërbimeve angazhon kuadër i cili ka përgatitje përkatëse dhe andragogjike që e ka fituar në mënyrë formale ose joformale.
- Ofruesi i shërbimeve lidh marrëveshje me kuadrin arsimor në të cilën janë të defnuara obligimet dhe përgjegjësitë si dhe

kushtet e punës. Ofruesi i shërbimeve kujdeset për zhvillimin e njohurive, shkathhtësive dhe kompetencave të kuadrit të vet dhe nëpërmjet kësaj siguron arsim më cilësor.

3.4. Ofruesi i shërbimeve ka kushte përkatëse hapësinore mjete ndihmëse dhe arsimore për realizimin e aktiviteteve të caktuara arsimore

- Ofruesi i shërbimeve i ka siguruar kushtet hapësinore, mjetet arsimore dhe ndihmëse sipas numrit të pjesëmarrësve, në aktivitetet programore, sipas Rregullores për standardet, për hapësirën, pajisjen e enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve dhe dispozitave të Ligjit për arsimimin e të rriturve, Ligjit për arsim fillor, Ligjit për arsim të mesëm, Ligjit për trajnim dhe arsim përkatës, Ligjit për arsim sipëror dhe dispozitat nga aktet nënligjore të cilat i rregullojnë standardet për hapësirë dhe pajisje për arsimin fillor, të mesëm dhe sipëror, dhe normat për mjete mësimore dhe ndihmëse për drejtimet në arsimin e mesëm katërvjeçar, të cilat mund të gjenden në faqen e internetit të Qendrës për arsim dhe trajnim përkatës: www.csoo.edu.mk.
- Programet e veçanta për arsimimin e të rriturve, realizohen në hapësirat e ofruesëve të shërbimeve të cilat janë të ndërtaur dhe të pajisura në pajtim me standardet e caktuara me rregulloren për standardet, për hapësirën, për pajisjet e enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve dhe normat për mjete mësimore dhe ndihmëse për drejtimet në

arsimin e mesëm përkatës katërvjeçar. Hapësirat në të cilat realizohen programet për arsimimin e të rriturve duhet të jenë në pronësi të ofruesëve të shërbimeve ose të jenë marrë me qira.

- Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë hapësira për realizimin e mësimin teorik dhe praktik, ose mësimi praktik mund të realizohet në firma, me marrëveshje të nënshkruar paraprakisht në mes të dy palëve.
- Ofruesi i shërbimeve i plotëson rregullat e parapara për mbrojtjen e shëndetit të të punësuarëve dhe pjesëmarrësve në aktivitetet mësimore, dhe i njëjti është i obliguar të sigurojë vendim nga institucione përkatëse për plotësimin minimal të kushteve higjienike dhe teknike, për hapësirën në të cilën realizohet arsimi i të rriturve.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

3.5. Informimi i rregullt i Ministrisë për arsim dhe shkencë nga ana e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve

Ofruesi i shërbimeve e informon Ministrinë për ndryshimet e kushteve hapësinore në afat prej 15 ditëve nga ndryshimi i ndodhur.

- Ofruesi i shërbimeve dorëzon raport vjetor deri të Ministria për arsim dhe shkencë për rezultatet e vlerësimit të

brendshëm, vlerësim i cili kryhet sipas kriterëve të caktuara nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve..

4. Dorëzimi i kërkesës për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve të cilat ofrojnë programe të veçanta për arsimimin e të rriturve, të cilat dërgojnë drejt kualifikimeve profesionale

Entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve të cilat ofrojnë programe të veçanta për arsimimin e të rriturve, të cilat dërgojnë deri të kualifikimet profesionale, e që dëshirojnë të jenë ofrues të liçencuar të shërbimeve në sferën e arsimit të të rriturve, duhet paraprakisht të njihen me procedurën për liçencim nëpërmjet këtij doracaku dhe kërkesës për liçencim të

enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve. Këto janë të vendosura në faqen e internetit të Ministrisë së arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë: www.mon.gov.mk dhe IP Qendra për arsimimin e të rriturve www.cov.gov.mk.

Liçencimi i enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, kryhet në bazë të plotësueshmërisë së standardeve për cilësi, hapësirë dhe pajisje, në bazë të programit të veçantë të dorëzuar/verifikuar për arsimimin e të rriturve deri ose nga Qendra për arsimimin e të rriturve. Liçenca do të jepet për drejtimet me programe të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë deri të kualifikimet profesionale në pajtim me Klasifikimin kombëtar të profesioneve nga viti 2011 (vendosur në faqen e internetit të Entit shtetëror për statistikë www.stat.gov.mk) edhe atë për sferat/drejtimet si vijojnë:



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

- Drejtimi ekonomik – juridik
- Drejtimi shëndetësor
- Drejtimi tekstil dhe ai për përpunimin e lëkurës
- Drejtimi grafik
- Drejtimi elektroteknik
- Shërbimet personale
- Drejtimi hotelierik dhe turistik
- Drejtimi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit
- Drejtimi gjeodet dhe i ndërtimtarisë
- Drejtimi buqësor dhe veterinar
- Drejtimi i komunikacionit
- Gjimnazi sportiv
- Drejtimi gjeologjik, i minierave dhe i metalurgjisë
- Drejtimi kimi-teknologji
- Drejtimi i maqinerisë

Përderisa një ent/institucion për arsimimin e të rriturve ka liçencë për profesion ose profil të caktuar arsimor për ndonjë drejtim të caktuar (në bazë të programit të posaçëm të verifikuar), dhe nga Qendra për arsimimin e të rriturve kërkon verifikim për lëmij tjetër të posaçme e cila dërgon drejt kualifikimit profesional nga lëmia e njëjtë, mirëpo për profesion ose profil tjetër arsimor, për të cilën janë të nevojshme standarde të ndryshme për pajisje dhe për realizim të programit, në atë rast përsëri do të kontrollohet plotësueshmëria e kushteve dhe standardeve nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë.

Entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve të cilat duan të ofrojnë programe të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë deri të kualifikimet profesionale duhet që deri te Ministria e arsimit dhe shkencës me postë ose drejtpërsëdrejti, deri të arkiva t'i dorëzojnë këto dokumente edhe atë në pesë (5) ekzemplarë (një original dhe katër kopje):



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

- Kërkesë për liçencim (struktura e kërkesës është sqaruar në pikën 5.1. të këtij doracaku);
- Dokument për veprimtari të regjistruar, të lëshuar nga Regjistri qendror i R. së Maqedonisë;
- Statut të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
- Elaborat (struktura e të cilit është sqaruar në pikën 5.2. të këtij doracaku);
- Të dhëna për hapësirën dhe pajisjen: dëshmi për pronësinë/qiramarrjen, dëshmi për kushtet urbanisitke dhe strukturën e hapësirës;

Pas pranimit të dokumentacionit, Minsitria për arsim dhe shkencë i shqyrton dokumentet e dorëzuara, i kontrollon të njëjtët a thua janë të kompletuara, formularët e plotësuar dhe kopjet e dokumentacionit të nevojshëm nëse japin informata të mjaftueshme për procesin e liçencimit të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve dhe në bazë të krejt këtyre të dhënave, sjell vendim për atë se a thua do t'i jepen këto dokumente Komisionit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve ose, prapë do t'i kthehen ofruesit të shërbimeve për arsimimin e të rriturve. Përderisa dokumentet nuk janë të kompletuara, në afat prej 10 ditëve, me shkresë informohet ofruesi i shërbimeve për arsimimin e të rriturve,

- Fletëpagesë për pagesën e kryer të taksës për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, në llogari të Ministrisë për arsim dhe shkencë (informata rreth kësaj janë dhënë në faqen e internetit të Ministrisë për arsim dhe shkencë).
- Vendimi për verifikim të programit të posaçëm për arsimimin e të rriturve deri të Ministria e arsimit dhe shkencës, të dorëzohet nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve, e jo nga enti/institucioni për arsimimin e të rriturve.

që të dorëzojë pjesën shtesë të dokumentacionit. Ofruesi i shërbimeve është i obliguar që, pas pranimit të lajmërimit, në afat prej 8 ditëve, të kompletojë dokumentacionin në fjalë dhe përsëri ta dorëzojë në Ministrinë për arsim dhe shkencë.

Data kur dokumentacioni zyrtarisht është pranuar nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë, është data prej kur fillon të llogaritet afati prej 60 ditëve, në të cilin është paraparë të lëshohet vendimi për liçencim të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë të R. së Maqedonisë.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

4.1. Shqyrtim i dokumentacionit të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve

Pas pranimit të dokumenteve nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë, ato i dorëzohen Komisionit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, i cili përbëhet nga katër anëtarë, (një nga Ministria për arsim dhe shkencë, një nga Qendra për arsimimin e të rriturve dhe Inspektorati shtetëror i arsimit, kurse anëtari i katërt zgjedhet në varshmëri nga lloji i programit të posaçëm (drejtimi, profili, profesioni), nga radhët e Qendrës për arsim dhe trajnim profesional, Byroja për zhvillim të arsimit, vetëqeverisja lokale në rast se është themeluese e entit, univerziteti, partnerët social dhe personat profesional, kualifikimi i të cilëve mundëson shqyrtim profesional të dokumentacionit të dorëzuar për liçencim. Kryetar i komisionit është anëtari nga Ministria për

arsim dhe shkencë. Komisioni ka për detyrë që në afat prej 60 ditëve, sipas qasjes në dokumentacion, mendimin për verifikim të programit të posaçëm për arsimimin e të rriturve, të dorëzuar nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve dhe pas vizitës së kryer në hapësirat e ofruesit të shërbimeve, t'ia dërgojë ministrit për arsim dhe shkencë.

Në këtë fazë Ministria për arsim dhe shkencë mund të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve për arsimimin e të rriturve, informata plotësuese për entin/institucionin. Ofruesi i shërbimeve është i obliguar që t'i dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara në afat të caktuar nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë.

4.2. Veprimet për miratimin e vendimit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve

Komisioni për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, e analizon dokumentacionin e aritur dhe e vlerëson kualitetin e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve. Secili anëtar i Komisionit e analizon dokumentacionin dhe vlerëson se a thua janë plotësuar standardet e definuar. Nëse pas analizimit të dokumentacionit, enti/institucioni për arsimimin e të rriturve i plotëson kushtet, kryhet një kontroll në punën e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve.

Ministria për arsim dhe shkencë ka për obligim të informojë gojarisht ose me shkrim entin/institucionin në afat prej 15 ditë para vizitës së planifikuar.

Enti/institucioni gjatë vizitës në punë, është i obliguar që Komisionit t'ia sigurojë të gjitha të dhënat e kërkuara, si edhe qasje dhe pamje të lirë në procesin arsimor dhe në procesin e udhëheqjes.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe vizitës së kryer, kryetari i komisionit në afat prej 8 ditëve përgatit raport për plotësueshmërinë e standardeve dhe kushteve dhe ia dërgon ministrit të arsimit dhe shkencës, për mendimin e tij rreth kushteve dhe Standardeve për liçencim, ky raport përmban këto elemente:

- analizë dhe vlerësim për plotësueshmërinë e Standardeve dhe kushteve për punë të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
- mangësitë në kuptim të plotësueshmërisë së standardeve dhe kushteve për punë të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
- propozime dhe sugjerime për përmirësimin e kushteve për punë të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve.

Në bazë të raportit të dorëzuar nga Komisioni për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, ministria

për arsim dhe shkencë, ofruesit të shërbimeve i jep vendim për kryerjen e veprimtarisë nga lëmia e arsimit për të rritur. Ofruesit e shërbimeve të cilëve nuk ju jepet vendim për liçencim, me shkrim informohem për arsyet e refuzimit të dhënies së vendimit për liçencim, me propozime për përmirësimin e standardeve dhe kushteve për punë të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve.

Vendimi për liçencim për kryerjen e veprimtarisë nga lëmia e arsimit të të rriturve jepet për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve.

Ofruesit e liçencuar të shërbimeve regjistrohen në Regjistrin e enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve, të cilin e mban Ministria për arsim dhe shkencë si dhe në Regjistrin komunal të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve të cilët realizojnë programe publikisht të njohura për arsimimin e të rriturve.

4.3. Mbikëqyrje inspektorale nga ana e Inspektoratit shtetëror të arsimit

Inspektorati shtetëror i arsimit kryen mbikëqyrje inspektorale dhe mbikëqyrje cilësinë e punës së entit/institucionit të liçencuar për arsimimin e të rriturve. Kjo mbikëqyrje kryhet sipas kriterëve të definuar nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë dhe implementohet nga persona të autorizuar nga Inspektorati shtetëror i arsimit.

4.4. Tërheqja e vendimit për liçencim të enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve

Në bazë të informatave dhe raporteve të marra nga mbikëqyrja e Inspektoratit shtetëror të arsimit për cilësinë e punës së entit/institucionit për arsimimin e të rriturve, Ministria për arsim dhe shkencë mund të miratojë vendim për tërheqje, marrje të liçencës për kryerje të veprimtarisë nga lëmia e arsimit për të rritur. Ministria për arsim dhe shkencë duhet që t'i dorëzojë entit/institucionit sqarime të detajuara për arsyet për tërheqje të përkohëshme të vendimit për liçencim për kryerjen e veprimtarisë nga lëmia e arsimit të të rriturve.

Tre muaj para skadimit të liçencës për kryerjen e veprimtarisë nga lëmia e arsimit për të rritur, enti/institucioni për arsimimin e të rriturve, dërgon deri të Ministria për arsim dhe shkencë, kërkesë për ri-liçencim. Me kërkesën për ri-liçencim dorëzohen edhe dokumentet të cilat janë të shpallura në faqen e internetit të Ministrisë së arsimit dhe shkencës.

5. Plotësim i kërkesës për liçencim dhe përgatitje e elaboratit

5.1. Kërkesa për liçencim

Kërkesa për liçencim për arsimimin e të rriturve i përmban këto të dhëna:

1. Emri i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve
2. Numri i telefonit, posta elektronike, adresa dhe komuna
3. Statusi (lloji i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve: shtetëror, publik, privat, joqeveritar etj.)
4. Numri i pjesëmarësve në arsimin për të rritur (në vjet)
5. Numri i arsimtarëve/trajnesëve me punësim të përhershëm
 - Numri i arsimtarëve/trajnesëve të angazhuar me honorar
 - Numri i bashkëpunëtorëve profesional
 - Numri i punëtorëve administrativ dhe financiar

- Numri i mbajtësve të higjienës
 - Numri i të punësuarëve të tjerë
6. Themeluesi i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve
 - Emri i themeluesit
 - Vendi
 - Numri dhe data e aktit të themelimit
 7. Hapësira për kryerjen e veprimtarisë
 - sipërfaqja e përgjithshme (në m²)
 - numri i përgjithshëm i:
 - klasave, kabineteve, hapësirave të tjera.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

8. Pajisjet: përshkrim i shkurtë i pajisjeve më të rëndësishme. Dorëzohet listë e paisjeve më të rëndësishme dhe vlera e tyre momentale.
9. Deklaratë. Me deklaratën, drejtori:
 - e vërteton saktësinë e informatave të përmbajtura në formularin e elaboratit;
 - vërteton se elaborati është plotësuar në pëlqim me Doracakun për liçencim të enteve/institucioneve për arsimimin e të rriturve;

- vërteton se janë të plotësuara të gjitha standardet dhe kushtet e nevojshme për implementimin e programit;
 - dakordohet që të kryhet kontroll në punën e entit/institucionit, nga ana e institucioneve përkatëse.
10. Emri dhe mbiemri i drejtorit, nënshkrimi dhe vula e entit/institucionit.

5.2. Elaborati

Elaborati i përmban këto elemente:

- Vizionin e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
 - Misionin e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
 - Profilin e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
 - Qëllimin parësor të veprimtarisë arsimore të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve;
 - Qëllimet dhe mënyrat specifike për arritjen e tyre;
 - Obligimet e entit/institucionit dhe të arsimtarëve/trajnuësëve në arritjen e qëllimeve;
 - Lloji dhe numri i programeve të cilat implementohen në entin/institucionin për arsimimin e të rriturve;
 - Lloji dhe numri i programeve për arsimimin e të rriturve që implementohen në entin/institucionin për arsimimin e të rriturve;
- Kuadri arsimor (të punësuar të përhershëm dhe ato me honorar);
 - Organizimi i mësimit për arsimimin e të rriturve;
 - Kushtet hapësinore dhe teknike dhe pajisja për realizim të programit për arsimimin e të rriturve;
 - Plotësueshmëria e rregullave për implementim të arsimit për të rritur;
 - Organi i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve, organizimi i brendshëm:
 - Këshilli drejtues;
 - Udhëheqje dhe drejtim i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

6. Shtojcë

6.1. Shtojca 1: Definicionet për kuptimet (sipas Ligjit për arsimimin e të rriturve në R. e Maqedonisë dhe terminologjisë së CEDEFOP¹):

Verifikim i programeve arsimore	Paraqet proces i sigurimit të cilësisë nëpërmjet dhënies së verifikimit të programit arsimor, e cila vërteton se programi është i kontrolluar nga institucione profesionale dhe relevante sipas rregullave ligjore dhe i plotëson standardet e definuar.
Mësim i përjetshëm	Nënkupton të gjitha aktivitetet arsimore të ndërmara gjatë jetës të cilat rezultojnë me përmirësim të njohurive, shkathhtësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për zhvillim social, profesional apo personal.
Arsimimi jo formal	Është mësimi i cili del nga aktivitetet e përditshme lidhur me punën, familjen ose me kohën e lirë. Nuk është i organizuar ose i strukturuar në lidhje me qëllimet, kohëzgjatjen dhe përkrahjen e procesit arsimor. Mësimi joformal në shumicën e rasteve është i paqëllimshëm nga ana e pjesëmarrësit.
Kualifikimi	Paraqet një dokument (të thjeshtë të njohur edhe si “çertifikatë” ose “diplomë”) i lëshuar nga trupi i autoizuar, i cili vërteton se personi ose e ka kryer programin arsimor, ose ka aritur nivel të caktuar të kompetencës për ndonjë profesion të caktuar.
Kompetencat kryesore janë	<ol style="list-style-type: none">1) Komunikim në gjuhën amëtare2) Komunikim në gjuhën e huaj3) Kompetenca numerike dhe kompetenca themelore nga lëmia e shkencës dhe teknologjisë4) Kompetenca digjitale5) Mësim racional6) Kompetenca sociale dhe qytetare7) Kompetenca ndërmarëse8) Vetëdije kulturore dhe shprehëse

¹ CEDEFOP: European guidelines for validating non-formal and informal learning, Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg 2009 (Udhëzimet europiane për verifikim e mësimit formal dhe joformal, Zyra për botime zyrtare të Komunitetit Evropian, Luksemburg 2009)



Kompetencat	Janë aftësi për përdorimin adekuat të rezultateve arsimore në kontekst të defnuar (arsimor, në vendin e punës, në zhvillimin personal dhe profesional).
Mësim në largësi	Nënkupton arsimin ose trajnimin në largësi nëpërmjet medimeve të komunikimit: libra, radio, TV, telefon, korespondencë, kompjuter ose video komunikim.
Arsimtari në arsimin për të rritur	Është person i cili ka status të arsimtarit në arsimin e të rriturve, sipas dispozitave ligjore dhe/ose sipas përvojës në një shtet të caktuar.
Arsimimi jo formal	Paraqet arsimin i cili nënkupton aktivitete të planifikuara të cilat nuk janë të shënuara në mënyrë të veçantë si mësim (në lidhje me qëlimet arsimore, kohëzgjatjen ose përkrahjen gjatë mësimin). Arsimi jo formal ndodh me qëllim të pjesëmarrësit në arsim.
Arsim i të rriturve	Paraqet spektër të gjërë të aktiviteteve arsimore nga lëmia e arsimin formal, jo formal dhe informues, të cilat janë ndërmarë nga ana e personave të rritur pas një ndërprerje nga lëshimi i arsimin dhe trajnimin fillestarë dhe të cilat rezultojnë me përfitimin e njohurive dhe shkathtësive të reja. <i>Vërrejtje:</i> Kjo nënkupton edhe arsimin e lartë universitar, nëse ka filluar pas ndërprerjes së arsimin dhe trajnimin fillestar.
Rezultatet arsimore	Janë dëshmi me anë të të cilave i tregohet pjesëmarrësit se çka duhet të dijë, të kuptojë dhe/ose të jetë në gjendje të demonstrojë pas mbarimit të programin.
Trajnim në vendin e punës	Është trajnim profesional i kryer në situatë normale të punës. Mund të përbëhet vetëm nga trajnimi në vendin e punës ose i kombinuar me trajnim i cili nuk kryhet në vendin e punës.
Trajnues në arsimin e të rriturve	Është person i cili punon me pjesëmarrës të rritur në përfitimin e njohurive ose shkathtësive praktike, ekspertiza e të cilit nuk duhet patjetër të jetë përfituar nëpërmjet kualifikimeve formale.
Kualifikime të pjesërishme	Paraqesin pjesë të kualifikimeve që përfitohen me programe të cilat organizohen me qëllim të përmirësimit, apo plotësimit të njohurive ekzistuese.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

Njohje e rezultateve arsimore	Paraqet njohjen e rezultateve arsimore: Vërtetim nga një institucion ose organ relevant me çka tregon se rezultatet arsimore (njohuritë, shkathtësitë dhe/ose kompetencat), të cilat një person i ka përfitur në kontekst të arsimit formal, joformal apo infomativ, sipas kriterëve të caktuara, i plotësojnë standardet e parashtruara për njohje. Njohja thjesht dmth çertifikim.
Korniza për kualifikim	Paraqet instrument për zhvillim dhe klasifikim të kualifikimeve psh (në nivelin kombëtar ose sektorial) sipas kriteriumeve (për shembull duke përdorur përshkrues) për përdorim në nivele të caktuara, të rezultateve arsimore.
Çertifikata	Është dokument me të cilin vërtetohet përfundimi i ndonjë programi të veçantë për arsimimin e të rriturve.
Çertifikim	Paraqet çertifikim të rezultateve arsimore: apo proces me të cilin formalisht vërtetohet se rezultatet e caktuara arsimore (njohuritë, shkathtësitë dhe/ose kompetencat që i ka përfitur një person vlerësohen dhe njihen nga ana e institucioneve përkatëse sipas standardeve të caktuara paraprakisht. Çertifikimi dërgon drejt lëshimit të çertifikatës, diplomës ose titullit.
Standardi i profesionit	Standardi i profesionit, paraqet dokument për caktimin e llojit, nivelit dhe kërkesat e punës dhe kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme.
Kualifikim profesional	Paraqet aftësi profesionale për kryerjen e ndonjë profesioni të caktuar ose të një pjese, e cila arrihet në bazë të pjesëve të verifikuara të programit arsimor.
Arsim dhe trajnimi profesional	Arsimi dhe trajnimi të cilët kanë për qëllim t'ju mundësojnë njerëzve dituri, shkathtësi dhe/ose kompetenca të nevojshme, për të kryer profesione të caktuara edhe në tregun më të gjerë të punës.
Enti/institucioni për arsimimin e të rriturve	Është organizatë ose person i cili kryen aktivitete arsimore për të rriturit.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme

Pjesmarës në arsimin për të rritur	Është personi i cili inkuadrohet në programet arsimore për të rritur, e që paraprakisht i ka plotësuar kushtet në aspektin e arsimit paraprak të obligueshëm dhe persona tjerë të cilët arsimohen por që nuk kanë statusin e nxënësit.
Arsimi formal	Arsimi i cili kryhet në mjedis të organizuar strukturor (për shembull në institucion për trajnim ose në vendin e punës) dhe identifikohet si mësim (në lidhje me kohëzgjatjen dhe resurset). Arsimi formal ndodh me qëllim të pjesëmarësit dhe si zakonisht dërgon drejt verifikimit dhe çertifikimit.



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Unitet Nations
Development Programme